



Funded by
the European Union



UDHËZIM

për zyrtarët e ministrive
të punëve të brendshme
dhe shërbimeve policore
**për komunikimin
me mediat në rastet e
keqpërdorimit të armëve
të zjarrit në dhunën
me bazë gjinore**

UDHËZIM

për zyrtarët e ministrive
të punëve të brendshme
dhe shërbimeve policore
**për komunikimin
me mediat në rastet e
keqpërdorimit të armëve
të zjarrit në dhunën
me bazë gjinore**



Zyra Qendrore e Evropës Lindore dhe Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (SEESAC) është një iniciativë e përbashkët e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (KBR), e cila ka për qëllim forcimin e kapaciteteve të aktorëve kombëtarë dhe rajonalë për kontrollin dhe pakësimin e përhapjes dhe keqpërdorimit të armëve të vogla dhe të lehta, me qëllim rritjen e stabilitetit, të sigurisë dhe të zhvillimit në Evropën Juglindore dhe Lindore.

Botimi i këtyre Udhëzimeve është bërë i mundur falë mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian, në kuadër të projektit *"Mbështetje për përmirësimin e luftës kundër zotërimit të jashtëligjshëm, keqpërdorimit dhe trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta në Ballkanin Perëndimor"* (IPA/2021/425-067), të zbatuar nga UNDP SEESAC.

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të vetë autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal apo të Bashkimit Evropian. Për më tepër, përcaktimet dhe materialet e përdorura në këtë botim nuk nënkuptojnë shprehjen e asnjë opinioni nga ana e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, ose të Bashkimit Evropian për sa i përket 1) statusit ligjor të secilit vend, territor ose zonë, ose të autoriteteve apo grupeve të tij të armatosura; ose 2) përcaktimit të vijave kufitare ose kufijve të tyre.

Për më shumë informacione, kontaktoni:

Drejtuesen e SEESAC
Bulevar Zorana Đinđića 64,
11000 Beograd, Srbija
Tel: +381 11 415 5300
www.seesac.org

Dizajni dhe faqosja: Ivan Čulafić
Printimi: Digital Solution Beograd
Qarkullimi: 80 copë
ISBN-978-86-7728-374-2

FALËNDERIME

Këto Udhëzime janë rezultat i bashkëpunimit ndërmjet SEESAC dhe i grupit të rrjetit të gazetarëve kundër dhunës ndaj grave, me kontributin e veçantë të dy anëtareve të këtij rrjeti, Jovana Gligorijević dhe Ana Manojlović. Rrjeti i gazetarëve kundër dhunës ndaj grave është një grup i përbërë nga më shumë se 80 gazetarë dhe redaktorë që luftojnë, në mënyrë të organizuar, publike dhe intensive, kundër dhunës ndaj grave. Anëtarët e rrjetit advokojnë që kjo çështje të paraqitet si një problem social në raportimet e mediave për rastet e dhunës ndaj grave, të cilat duhet të vënë në dukje shkaqet e këtij fenomeni, të dënojnë qartësisht çdo formë dhune dhe të nxisin rritjen e llogaridhënies nga autorët dhe institucionet përgjegjëse për mbrojtjen nga dhuna.

Redaktorja e këtij botimi është Iva Savić, Analiste Projekti në SEESAC. Në këtë botim kanë kontribuar gjithashtu informacionet dhe të dhënat e rëndësishme nga pjesëtarët e mëposhtëm të ekipit të SEESAC: Jelena Bujaković - Specialiste e projektit për AVL-të, Dragan Božanić - Specialist i projektit të SEESAC për Hulumtimet dhe Çështjet Gjinore, Danijela Đurović - Analiste Projekti, Vesna Cipruš - Këshilltare e Lartë për Çështjet Gjinore, si dhe Violeta Gaši - Bashkëpunëtore e Programit.

AKRONIME

IPA	Instrumenti i Asistencës së Paraanëtarësimit
MB	Ministria e Brendshme
KBR	Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal
DhBGj	Dhunë me Bazë Gjinore
AVL	Armë të Vogla dhe të Lehta
SEESAC	Zyra Qendrore e Evropës Lindore dhe Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

HYRJE

Analiza e artikujve të mediave lidhur me keqpërdorimin e armëve të zjarrit në rastet e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor (2024), e cila është botuar nga SEESAC, tregoi se institucionet janë një burim kryesor informacioni për mediat lidhur me këtë temë dhe shpeshherë, deklaratat e tyre për shtyp publikohen fjalë për fjalë. Ndër institucionet më të përfaqësuara janë ministritë e punëve të brendshme dhe shërbimet policore.

Për këtë arsye, kur bëhet fjalë për këtë fenomen, ministritë e punëve të brendshme dhe shërbimet policore, kanë një ndikim të madh në formimin e opinionit publik nëpërmjet informacioneve që japin rreth problematikës së dhunës me bazë gjinore (DhBGj) në formën e njoftimeve, deklaratave për shtyp dhe intervistave.

Bazuar në sa më sipër, rezulton se ministritë dhe oficerët e policisë janë aleatë të natyrshëm të medias në raportimin e këtij problemi dhe se ata mund të kontribuojnë ndjeshëm jo vetëm në përmirësimin e cilësisë së raportimeve të mediave, çka është në interes të publikut, por mund të kenë gjithashtu një ndikim të drejtpërdrejtë në mënyrën se si publiku e percepton problemin.

Në përgjithësi, juridiksionet e Ballkanit Perëndimor kanë një përkufizim të "interetit publik" në ligjet e tyre për median dhe në vijim kemi dhënë një shpjegim nga Rrjeti i Gazetarisë Etike, i cili përmbledh ato përkufizime.¹

"Interesi publik ka të bëjë me atë që ka rëndësi për të gjithë në shoqëri. Ai referohet të mirës së përbashkët, mirëqenies së përgjithshme dhe sigurisë së çdo qytetari. Interesi publik nuk ka të bëjë vetëm me atë që audiencës i duket interesante dhe argëtuese. Përkundrazi, ka të bëjë me çështje që kanë ndikim të drejtpërdrejt tek ta, edhe nëse nuk ata vetë nuk janë të vetëdijshëm ose duket se nuk janë të interesuar".

1 Rrjeti i Gazetarisë Etike ([Ethical Journalism Network](#)) është një rrjet i gazetarëve, redaktorëve, pro-narëve të mediave dhe grupeve mbështetëse të medias me bazë në Mbretërinë e Bashkuar.

Përgatitja e udhëzimeve u parapri nga një punë disamujore e SEESAC, e anëtarëve të rrjetit të gazetarëve kundër dhunës ndaj grave, si dhe e një grupi gazetarësh nga pesë juridiksionet e Ballkanit Perëndimor, për analizimin e artikujve të mediave rreth keqpërdorimit të armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës me bazë gjinore. Qëllimi ishte të përcaktohej se si raportojnë mediat rreth këtij fenomeni, si dhe cilat janë pikat kryesore të dobëta dhe të forta të raportimit të mediave. Analiza trajtoi temat në vijim: portretizimi në media i rasteve specifike dhe i autorëve; portretizimi në media i viktimave/të mbijetuarave të dhunës dhe i fenomenit të dhunës; fotografitë dhe elementet vizuale që përdorin mediat në trajtimin e temës së keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën me bazë gjinore; shkalla në të cilën mediat përmbushin funksionin e tyre edukativ në lidhje me këtë fenomen.

Analiza përfshiu 24 949 artikuj mediatike që raportojnë rreth incidenteve me armë zjarri, nga të cilat 1484 në kontekstin e dhunës ndaj grave dhe këto përmbajtje u analizuan në detaje lidhur me treguesit e paracaktuar. Analiza përdori përmbajtjet mediatike që mblidhet sistematikisht nga SEESAC për nevojat e Platformës së Monitorimit të Dhunës me Armë ([Armed Violence Monitoring Platform - AVMP](#)), e cila shërben për të identifikuar dhe analizuar tendencat përkatëse në Evropën Juglindore. Treguesit janë zhvilluar në bazë të kodeve të etikës së shoqatave të gazetarëve në juridiksionet përkatëse të mbuluara nga analiza, si dhe në bazë të [Udhëzimeve për raportimin etik mbi dhunën ndaj grave](#), të hartuara nga rrjeti i gazetarëve kundër dhunës ndaj grave.

Rezultatet e analizës shërbyen si bazë për përgatitjen e Udhëzimeve për zyrtarët e ministrive të punëve të brendshme dhe shërbimeve policore, për t'i ndihmuar ata që të informojnë sa më shumë median dhe publikun në përputhje me interesin publik.

Për të ndihmuar në uljen e kërcënimit nga keqpërdorimi dhe mbajtja e jashtëligjshme e AVL-ve, në qershor 2022, [SEESAC krijoi Task Forcën Rajonale për Rritjen e Ndërgjegjësimit](#), e cila punon në mënyrë të dedikuar për këtë problematikë. Në kuadër të punës së saj, SEESAC mbledh dy herë

në vit përfaqësues të ministrive të brendshme dhe shërbimeve policore nga gjashtë juridiksionet e Ballkanit Perëndimor, puna e të cilëve është e lidhur drejtpërdrejt me veprimtaritë për rritjen e ndërgjegjësimit rreth AVL-ve.

Gjatë [takimit të mbajtur më 3 tetor 2023](#), pjesëmarrësit e kësaj Task Force patën mundësinë të njiheshin me Udhëzimet dhe të diskutonin rreth tyre. Udhëzimet iu dërguan gjithashtu më pas në mënyrë elektronike pjesëmarrësve dhe u finalizuan bazuar në komentet e marra prej tyre. Versioni përfundimtar i Udhëzimeve iu prezantua grupit të punës në [takimin e mbajtur më datë 3 prill 2024](#).

Hartimi i Udhëzimeve kontribuon drejtpërdrejt në zbatimin e [*Udhërrëfyesit për një zgjidhje të qëndrueshme për zotërimin e jashtëligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e armëve të vogla dhe të lehta \(AVL\) dhe municioneve të tyre në Ballkanin Perëndimor*](#), me fokus tek Objektivi 4 i Udhërrëfyesit: Të ulet në mënyrë të konsiderueshme oferta, kërkesa dhe keqpërdorimi i armëve të zjarrit nëpërmjet ndërgjegjësimit, edukimit, informimit dhe promovimit të kontrollit.

UDHËZIMET PËR KOMUNIKIMIN ME MEDIAT

1 PANORAMA E PLOTË E SITUATËS



► **PROBLEMI:** Analiza rajonale e artikujve mediatike që mbulon keqpërdorimin e armëve të zjarrit në kontekstin e DhBGj-së tregoi se pjesa dërrmuese e këtyre përmbajtjeve, përkatësisht deri në 91%, trajtojnë vetëm raste individuale dhe jo fenomenin në tërësi. Kjo është diçka negative pasi i jep publikut përshtypjen se ky është një fenomen i izoluar, një problem privat mes dhunuesit dhe viktimës, apo diçka që thjesht ndodh dhe nuk mund të parandalohet.

► **ZGJIDHJA:** Krahas informacionit bazë rreth një incidenti të caktuar ose një vepre penale me armë zjarri, gazetarëve duhet t'u jepet gjithashtu një kontekst më i gjerë i ngjarjes:

- sa ka qenë shpeshtësia e këtyre incidenteve në juridiksionin tuaj gjatë 5 viteve të fundit;
- cilat janë tendencat në vitin aktual;
- cilat janë vendndodhjet e detajuara ku ndodh më shpesh dhuna ndaj grave – shumica e rasteve të DhBGj-së ndodhin në hapësira private: banesa, apartamente, shtëpi dhe oborre (të ashtuquajtura "vendndodhje të detajuara"), dhe rrjedhimisht, është e rëndësishme të theksohet fakti se gratë janë më të cenueshme në hapësirat e tyre private;
- cila është marrëdhënia më e zakonshme mes dhunuesit dhe viktimës – zakonisht, viktima e nje paraprakisht autorin e dhunës me bazë gjinore (bashkëshorti, partneri, ish-partneri), ndaj është mirë të nënvizohet ky aspekt i dhunës;
- nevojitet fokus edhe në rastet e keqpërdorimit të armëve me pasoja jo fatale (kërcënime, plagosje etj.);
- në të gjitha rastet e raportimit të këtij fenomeni, të përmendet se çdo formë e dhunës ndaj grave është e papranueshme, në mënyrë që të ngrihet kapaciteti i qytetarëve për zero tolerancë ndaj kësaj lloji dhune;

- të përgatiten, në baza vjetore, statistika kyçe nga juridiksioni juaj përkatës dhe informacione bazë rreth fenomenit të DhBGj-së dhe të përfshihen në çdo njoftim për shtyp, deklaratë dhe intervistë.

Gjithashtu, duhet pasur parasysh se shumica e qytetarëve nuk kanë njohuri dhe/ose kanë perceptime të gabuara për mandatin e policisë, prokurorisë, gjykatave, qendrave për punë sociale, si dhe për procedurat e policisë në rastet e dhunës në familje dhe keqpërdorimit të armëve të zjarrit. Kjo do të thotë se ministria dhe policia kanë shumë hapësirë për të rritur nivelin e edukimit. Informacione të tilla si procedura për dhënien e armëve dhe procedura e konfiskimit të tyre, hapat që ndërmerr policia kur merr një denoncim për dhunë në familje, personat që mund të denoncojnë dhunën në familje pranë policisë dhe mënyra e denoncimit, procedura që ndiqet nëse dhunuesi është i dehur, procedura për të përcaktuar se kush ka qëlluar në rastet kur dyshohet për vetëvrasje të autorit pasi ka vrrarë një grua etj., janë me interes publik dhe duhet të ndahen në mënyrë aktive me median kur ndodh një incident i dhunës në familje.

Duke ofruar informacion edukativ në njoftime për shtyp, deklaratë dhe/ose intervista, do të reduktohet nevoja e medias për t'ju kërkuar informacione që konsiderohen sensacionale. Artikujt sensacionalë janë jo produktivë sepse paraqesin spekulime nga fqinjët dhe të njohurit, detajet e krimeve që nuk janë në interes të publikut etj.

SHËNIM: Nëse në juridiksionin tuaj ekziston instituti ligjor i hetimit të prokurorisë, prisni që Prokuroria përkatëse të paraqesë informacion rreth aspekteve që përfshihen në mandatin e tyre.

2 ROLI EDUKATIV



► **PROBLEMI:** Pjesa më e madhe e artikujve mediatike të trajtuara nga analiza rajonale tregojnë se gazetarët nuk publikojnë të dhëna dhe fakte që janë në interes të publikut. Nga ana tjetër, ministritë e punëve të brendshme/shërbimet policore janë pikërisht strukturat që mund të japin disa prej këtyre informacioneve me interes publik. Në vitin 2022, më pak se 10% e raportimeve të mediave në rajon përmbushnin rolin e tyre edukativ, pra të diskutonin më gjerësisht rreth fenomenit të DhBGj dhe keqpërdorimit të armëve të zjarrit. Kur bëhet fjalë për armët e zjarrit, është tejet e rëndësishme të theksohet se prania e armëve të zjarrit në shtëpi rrit rrezikun e vdekjes.

► **ZGJIDHJA:** Përdorni ekspertizën tuaj dhe statistikat e disponueshme për të pasur një ndikim edukativ te gazetarët dhe audienat e tyre. Hidhni dritë mbi fenomenet që çojnë në ndodhjen e incidenteve me armë zjarri në kontekstin e DhBGj-së:

- vendosni theksin te [cikli i dhunës](#) (shihni Udhëzimin XIV);
- theksoni se duhet pasur parasysh se dhuna, ku përfshihet dhuna me armë zjarri, nuk është vetëm fizike, por edhe verbale, psikologjike dhe ekonomike. Këto forma janë shpeshherë të pranishme dhe i paraprijnë dhunës fizike, e cila është përshkallëzim i abuzimit afatgjatë;
- mos u fokusoni vetëm në rastet me pasoja fatale, por edhe te dhuna fizike si fenomen;
- theksoni se DhBGj dhe keqpërdorimi i armëve të zjarrit janë probleme sociale dhe jo private;
- tregoni numrin e vdekjeve nga incidentet me armë zjarri në kontekstin e DhBGj-së dhe krahasojeni me numrin e vdekjeve në kontekstet e tjera ku përdoren armët e zjarrit;
- ndani me mediat informacione rreth mënyrave se si mund të marrin mbështetje gratë e ekspozuara ndaj dhunës.

3 MBRONI IDENTITETIN E AUTORIT DHE VIKTIMËS/TË MBIJETUARËS SA MË SHUMË QË TË JETË E MUNDUR



► **PROBLEMI:** Në shumicën e juridiksioneve, një problem i shpeshtë në raportimet e mediave është zbulimi i identitetit të viktimave dhe të mbijetuarve, si dhe i anëtarëve të familjes, duke përfshirë dhe të fëmijëve. Diçka e tillë ndodh në dy të tretat e raportimeve të mediave në të gjithë rajonin. Në shumicën dërrmuese të rasteve, viktimat e njëj paraprakisht dhunuesin. Duke zbuluar identitetin e dhunuesit, i jepni mundësinë mediave të mësojnë edhe identitetin e viktimës/të mbijetuarës. Kjo ka pasoja të rënda për të mbijetuarën dhe familjen e saj, si dhe për familjen e viktimës në rastet e humbjes së jetës. Interneti nuk harron asgjë, kështu që në të ardhmen, me një kërkim të thjeshtë, çdokush mund të mësojë gjithçka për një ngjarje traumatike, çka vë në rrezik privatësinë e të mbijetuarave dhe familjeve të tyre dhe pamundëson rikuperimin.

► **ZGJIDHJA:** Mos e nënvlerësoni kurrë kureshtjen e gazetarëve dhe aftësinë e tyre për të zbuluar identitetin e autorit. Shmangni çdo informacion që mund të ndihmojë në identifikimin e viktimave/të mbijetuarave: mbiemri i autorit të dhunës, fakti nëse ka lidhje me viktimën, fotografi nga vendngjarja ku dallohet emri i rrugës, numri i shtëpisë, godina të njohura etj. Gjithashtu, shmangni publikimin e moshës dhe inicialeve të të mbijetuarës/viktimës dhe autorit pasi mund të përcaktohen me lehtësi identitetet e tyre duke bërë disa kërkime pak më të avancuara në internet. Shmangni me çdo kusht mundësinë e traumatizimit dytësor. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur të mbijetuarat janë të mitura ose fëmijë: Interneti kujton gjithçka dhe mund t'u lërë gjurmë të përhershme dhe t'ua vështirësojë jetën.

4 MUND OHUNI QË TA FORMULONI NË MËNYRË SA MË TË GJERË VENDIN KU KA NDODHUR DHUNA



► **PROBLEMI:** Vendndodhja është një tjetër detaj me ndihmën e të cilit mediat mund të zbulojnë identitetin e autorit dhe viktimës, si dhe të familjeve të tyre, të cilat më pas mund t'i shqetësojnë.

► **ZGJIDHJA:** Kur jepni vendndodhjen, përmendni vetëm qytetin ku ka ndodhur dhuna dhe nëse është vendbanim rural, deklaroni se është një fshat në afërsi të qytetit më të madh përkatës që ndodhet pranë fshatit. Përrjashtim nga ky rregull bëjnë vendet dhe institucionet publike. DhBGj e kryer në objektet e mikpritjes ose institucionet publike tregon "moskokëçarjen" e autorit dhe është informacion me interes publik sepse ka një rol edukativ, pasi tregon se çfarë janë në gjendje të bëjnë njerëzit e dhunshëm.

5 INFORMONI MEDIAT PËR LLOJIN DHE ORIGJINËN E ARMËVE



► **PROBLEMI:** Edhe pse pjesa më e madhe e artikujve mediatike të analizuara përmendin llojin e armës, në 71% të tyre nuk ka informacion nëse autori e ka armën në pronësi të ligjshme apo të jashtëligjshme. Gjithashtu, mungojnë të dhënat për armët e tjera (lloji dhe sasia) që i janë gjetur autorit.

► **ZGJIDHJA:** Ky informacion është i një rëndësie të madhe për median dhe publikun, sepse shtron pyetjen se si përftohen armët e zjarrit, p.sh., nëse janë marrë ose jo në mënyrë të jashtëligjshme nga vendet e luftës, i jep mundësi medias të hetojë gabimet sistemike, të ushtrojë trysni ndaj institucioneve përkatëse për të punuar më mirë dhe në mënyrë më të përgjegjshme, si dhe për t'i kontaktuar për informacione shtesë. Gjithashtu, ky informacion është i dobishëm për viktimat e mundshme të dhunës, sepse i ndihmon ato të ndërgjegjësohen rreth kontekstit në të cilin ndodhen dhe të kuptojnë se janë në rrezik.

SHËNIM: Në juridiksionet ku ekziston instituti i hetimit të Prokurorisë, policia nuk jep informacion për origjinën, llojin dhe sasinë e armëve, pasi këto informacione jepen nga Prokuroria. Rrjedhimisht, ky rekomandim nuk vlen për ato juridiksione.

6 RAPORTONI RRETH HISTORIKUT TË MËPARSHËM TË SJELLJEVE TË DHUNSHME TË AUTORIT



► **PROBLEMI:** Më shumë se dy të tretat e raportimeve të mediave nuk përmendin informacion nëse autori ka shfaqur më parë sjellje së dhunshme ose nëse ka historik të keqpërdorimit të armëve të zjarrit.

► **ZGJIDHJA:** Sigurohuni që ta përfshini këtë informacion, veçanërisht nëse institucionet janë marrë më parë me autorin e krimit, si dhe specifikoni përgjigjen institucionale, nëse ka pasur një të tillë. Ky informacion është gjithashtu në interes të publikut, veçanërisht në interes të grave të rrezikuara, sepse i ndihmon të dallojnë kur janë në rrezik dhe të kërkojnë ndihmë në kohën e duhur. Gjithashtu, nëse është raportuar dhunë (me ose pa keqpërdorim të armëve të zjarrit), informoni publikun për rezultatin e këtyre raportimeve.

Nëse nuk ka raportime të mëparshme për dhunë, tregohuni të kujdesshëm dhe theksoni gjithmonë se kjo nuk do të thotë se nuk ka pasur dhunë. Sillni në vëmendjen e publikut faktin se shumë gra kanë frikë ta raportojnë autorin e dhunës.

Gjithashtu, informoni më shpesh mediat për dhunën që ka pasoja më pak drastike, në mënyrë që t'i mësoni se është një tregues rreziku për forma më të rënda të dhunës.

SHËNIM: Ky rekomandim nuk mund të zbatohet gjithmonë në juridiksionet ku informacionet për historikun e dhunës janë subjekt i ligjeve për mbrojtjen e të dhënave personale. Megjithatë, nëse keni informacion për historik të mëparshëm dhune dhe e keni mbrojtur mirë identitetin e autorit, vlerësoni nëse ekziston mundësia që ta jepni këtë informacion.

7 INFORMONI RREGULLISHT MEDIAT GJATË TË GJITHË HETIMIT



► **PROBLEMI:** Analiza rajonale e artikujve mediatike tregoi se në 80% të rasteve, mediat publikonin përfundimin e çështjes, pra arrestimin e autorit apo ngritjen e aktakuzës. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se mediat e ndjekin rastin nga fillimi deri në fund. Me kalimin e kohës zbehet interesi i mediave për përgjigjen institucionale dhe lajmet rreth vendimit përfundimtar rrallëherë arrijnë te publiku.

► **ZGJIDHJA:** Përgjigja institucionale ndaj keqpërdorimit të armëve të zjarrit në kontekstin e DhBGj-së është e rëndësishme sepse rrit dhe ruan besimin e qytetarëve te policia dhe institucionet gjyqësore. Po aq e rëndësishme është që me ndihmën e këtij informacioni, gratë të marrin mesazhin se si të mbrohen përmes instrumenteve ligjore. Në të njëjtën kohë, dhunuesit marrin mesazhin për pasojat e veprimeve të tyre. Informoni rregullisht mediat për çdo fazë: arrestimin, procesin e hetimit, referimin e çështjes në prokurori etj. Ftoni mediat që të vazhdojnë të ndjekin rezultatin e çështjes deri në përfundimin e saj, përmes punës së organeve gjyqësore. Duke vepruar kështu, do të inkurajoni mediat që të jenë të përgjegjshme dhe të raportojnë në interes të publikut. Në varësi të shkallës së rastit dhe rëndësisë së interesit publik, vlerësoni se cila formë komunikimi është më e përshtatshme në një moment të caktuar. Për shembull, arrestimi dhe aktakuza përbëjnë shpeshherë arsyen për dhënien e një konferencë dhe/ose deklaratë për shtyp.

8 JEPNI NJË PËRSHKRIM TË NGJARJEVE NË RASTET KONKRETE



► **PROBLEMI:** Disa juridiksione kanë emra të ndryshëm për vepra penale të ndryshme dhe policia nuk duhet ta klasifikojë vetë llojin e krimit. Për shembull, disa juridiksione parashikojnë veprën penale “DHUNË NË FAMILJE”, por policia nuk duhet ta përdorë këtë frazë derisa prokuroria të marrë vendimin për ta akuzuar autorin për këtë vepër penale.

► **ZGJIDHJA:** Edhe pse mund të jetë e qartë për të gjithë se incidenti përbën një rast të dhunës në familje, jo gjithmonë duhet ta themi shprehimisht diçka të tillë. Megjithatë, nuk ka pengesa për t’u treguar mediave në mënyrë përshkruese se çfarë ka ndodhur, pra për të specifikuar marrëdhënien mes autorit dhe viktimës (p.sh., një burrë në moshë të mesme ka qëlluar disa herë në drejtim të bashkëshortes së tij).

9 MOS KOMUNIKONI DETAJE NGA HETIMI QË E KALOJNË PËRGJEGJËSINË NGA AUTORI I DHUNËS TE VIKTIMA/E MBIJETUARA DHE MOS E SHPJEGONI DHUNËN NËPËRMJET RRETHANAVE TË JASHTME APO TIPAREVE PERSONALE TË AUTORIT



► **PROBLEMI:** Kalimi i përgjegjësisë nga dhunuesi te viktimat/e mbijetuara është i pranishëm në rreth një të pestën e përmbajtjeve mediatike në të gjashta juridiksionet. Gjithashtu, në një masë akoma më të madhe (31%), mediat përpiqen të shpjegojnë dhunën përmes rrethanave të jashtme (p.sh.: pushimi nga puna, problemet financiare) ose karakteristikave personale të autorit (alkoolizmi, kumari, sëmundjet mendore). Kjo është një praktikë e dëmshme sepse zvogëlon përgjegjësinë e autorit dhe i dërgon publikut mesazhin se akti ka qenë jashtë kontrollit të autorit. Në të njëjtën kohë, kjo praktikë dekurajon viktimat që të raportojnë dhunën.

► **ZGJIDHJA:** Çdo vepër penale ka një motiv apo arsye. Megjithatë, është e rëndësishme të dallojmë motivin dhe arsyen nga shkaku. Shkaku i dhunës është gjithmonë vendimi i autorit për të kryer një akt të dhunshëm. Nëse u tregoni mediave arsyet që e shtynë personit të merrte një vendim të caktuar (p.sh., “Vrau ish-bashkëshorten sepse ajo gjeti një partner të ri”), i jepni medias një mënyrë për të zhvendosur një pjesë të përgjegjësisë për aktin e dhunshëm te viktimat/e mbijetuara.

10 MOS U JEPNI MEDIAVE SHKAK PËR T'U "TALLUR" ME RASTET E DHUNËS



► **PROBLEMI:** Minimizimi ose tallja/ironia me rastet e dhunës, si dhe shfaqja e mosbesimit ndaj viktimës/të mbijetuarës është e pranishme në një nga pesë raportime mediatike. Kjo ndikon në opinionin publik duke ulur ndjeshmërinë e publikut ndaj dhunës dhe duke kontribuar në normalizimin e saj. Në disa raste, veprat penale me armë zjarri mund të përmbajnë detaje që media mund t'i përdorë për tallje (autori u godit nga një plumb rikoshet, plumbi ngeci në tytë, e mbijetuara i rrëmbeu armën autorit etj.)

► **ZGJIDHJA:** Në situata të tilla nevojitet kujdes i veçantë në lidhje me formulimin që do të përdorni. Kjo është një dukuri e zakonshme në rastet e keqpërdorimit të armëve të zjarrit që nuk rezultojnë në lëndime dhe/ose viktima, por edhe këto raste duhet t'i trajtoni me të njëjtin seriozitet si rastet në të cilat ka lëndime dhe viktima.

11 BËNI KUJDES NË ZGJEDHJEN E PËRMBAJTJES VIZUALE QË U DËRGONI MEDIAVE



► **PROBLEMI:** Analiza e artikujve mediatike tregoi se, në një numër të madh rastesh, përmbajtja vizuale mund të jetë ritraumatizuese për familjet e viktimave/të mbijetuarave. Përmbajtja vizuale më e përdorur në rastet e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës me bazë gjinore është arma, por në kulturat tona arma shihet si burim fuqie dhe dërgon një mesazh në kundërt me atë që duam të arrijmë. Në disa raportime të mediave janë përdorur zgjidhje të mira, si p.sh., fotografitë e duarve të ekspertëve të kriminalistikës apo tabela “STOP ARMËVE”.

► **ZGJIDHJA:** Edhe pse policia rrallëherë shpërndan foto dhe video, në rast se është e nevojshme përdorni zgjidhjen në vijim: është e vështirë të gjendet një metodë për të portretizuar vizualisht DhBGj-në dhe keqpërdorimin e armëve të zjarrit në një mënyrë që të mos krijojë shqetësim te publiku. Nëse dërgoni në media fotografi dhe video të një vendngjarjeje ose arrestimi, sigurohuni që t’ia fshihni fytyrën autorit/të dyshuarit. Në asnjë rrethanë, mos dërgoni pamje vizuale ku shfaqen armët dhe/ose viktimat, edhe kur ato janë të mbuluara me çarçafë ose brenda çantave të zeza. E njëjta gjë vlen edhe për njollat e gjakut dhe detaje të tjera. Kjo është e rëndësishme si për të mbrojtur identitetin po ashtu dhe për të ruajtur dinjitetin e viktimave, por edhe për të shmangur traumatizimin e familjeve të viktimave dhe shqetësimin e publikut. Për të gjetur shembuj pozitivë të ilustrimeve që portretizojnë problemin e dhunës në mënyrë të përgjegjshme dhe etike, vizitoni [bazën e të dhënave të fotografive dhe ilustrimeve](#) të përpiluar nga rrjeti i gazetarëve kundër dhunës ndaj grave.

12 MOS I JUSTIFIKONI DËSHTIMET E INSTITUCIONEVE



► **PROBLEMI:** Përpjekjet për të justifikuar dështimet në punën e institucioneve çojnë në rritjen e mosbesimit te këto institucione. Nëse gratë që përjetojnë dhunë nuk besojnë se mund të mbrohen, ato nuk do ta raportojnë dhunën, çka mund të çojë në pasoja fatale. Nëse pranoni se po punohet për të identifikuar dështimet dhe dobësitë e sistemit atëherë kjo tregon se institucioni është i gatshëm të bëjë punën e tij dhe ta përmirësojë atë.

► **ZGJIDHJA:** Në rastet kur është raportuar dhe mund të ishte parandaluar keqpërdorimi i armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje, mos e mohoni përgjegjësinë e mundshme të institucionit tuaj. Pranojeni gabimin, theksoni se gabimet mund të ndodhin në çdo punë, por në disa raste mund t'i kushtojnë dikujt me jetë. Shpjegojuni gazetarëve se cila është procedura për përcaktimin e përgjegjësisë në institucionin tuaj dhe tregojuni hapat që do të ndërmerreni. Informoni rregullisht mediat për ecurinë e kësaj procedure.

13 NJIHUNI ME KODET E ETIKËS SË GAZETARËVE NË JURIDIKSIONIN TUAJ PËRKATËS DHE KUJTOJUANI GJITHMONË KOLEGËVE KODET TUAJA



► **PROBLEMI:** Mediat kanë tendencë të sakrifikojnë etikën mediatike për të publikuar një lajm ekskluziv dhe sensacional. Ndonjëherë, për të publikuar lajme të tilla mediat gjejnë material pikërisht në njoftimet apo deklaratat për shtyp të zyrtarëve të ministrive të punëve të brendshme dhe policisë, të cilat janë burimet më të zakonshme për mediat. Ndonjëherë, problem janë të dhënat nga hetimi, të cilat nuk duhet të jenë publike, sepse cenojnë konfidencialitetin e hetimit.

► **ZGJIDHJA:** Është e rëndësishme që të veproni në mënyrë parandaluese. Gjithashtu, duke u njohur me standardet e etikës së raportimit të mediave, siguroheni që të mos bëheni burim i ritraumatizimit, stigmatizimit dhe viktimizimit dytësor të viktimave/të mbijetuarave. Nëse u rikujtoni vazhdimisht kolegëve kodet që rregullojnë profesionin e oficerit të policisë, do të keni një efekt edukues tek ta dhe do të zvogëloni numrin e oficerëve që janë të gatshëm t'u japin gazetarëve informacione rreth hetimit.

14 INFORMONI GAZETARËT PËR CIKLIN E DHUNËS



► **PROBLEMI:** Mundohuni të bindni gazetarët që të mos shkruajnë se vrasja ndodhi "papritur", "brenda natës", "në gjaknxehëtësinë e momentit" dhe se është e pashpjegueshme se si një fqinj i qetë, i urtë dhe i druajtur papritur "u çmend" dhe u bë vrasës. Kjo lloj mënyre e të shkruarit krijon perceptime të gabuara te njerëzit rreth vrasjes së grave (femicidit), natyrës së dhunës dhe dinamikave të pushtetit që vendos autori i dhunës mbi viktimën, si dhe dekurajon gratë e tjera të cilat përjetojnë dhunë që ta raportojnë autorin pranë institucioneve përkatëse.

► **ZGJIDHJA:** Theksoni natyrën e dhunës me bazë gjinore dhe modelet e dhunës në familje dhe dhunës nga partneri intim.

Situatat e dhunës në familje dhe dhunës nga partneri intim nuk ndodhin kurrë papritmas. Ato lindin pasi është krijuar një lidhje e fortë që është e vështirë të thyhet. Shpeshherë, partnerët e dhunshëm janë "të mirë" shumicën e kohës. Për këtë arsye, disa incidente të dhunës u atribuohen lehtësisht "një dite të keqe" që mund të ketë kaluar autori ose "humbjes së kontrollit si pasojë e stresit" dhe nuk portretizohen si sjellje realisht e dhunshme. Cikli i dhunës ka tre faza përsëritëse:

1. **"përgatitja" e viktimës:** vendosja e kontrollit mbi viktimën, manipulimi dhe izolimi nga familja dhe miqtë, çka përbën në fakt dhunë psikologjike dhe/ose ekonomike;
2. **përshkallëzimi i dhunës:** në shumicën e rasteve ushtrohet dhunë fizike dhe/ose seksuale;
3. **faza e "muajit të mjaltit":** autori i dhunës pendohet, i kushton vëmendje maksimale viktimës dhe i premton që nuk do e dhunojë më kurrë dhe ky është rasti i manipulimit dhe dhunës psikologjike.

Duke qenë se ky është një cikël, shumë shpejt autori kthehet te faza e para, ndërkohë që dhuna e ushtruar në fazën e dytë (përshkallëzimi i dhunës) është gjithnjë e më brutale. Sa më gjatë të qëndrojë viktima në këtë marrëdhënie, aq më shpejt do të përsëritet cikli dhe aq më të shkurtra do të jenë intervalet ndërmjet dy fazave të përshkallëzimit të dhunës.

FORMAT E KOMUNIKIMIT ME MEDIAT

NJOFTIMI PËR SHTYP



Në rastin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në kontekstin e DhBGj-së, njoftimi për shtyp është forma e parë e komunikimit me gazetarët. Në këtë mënyrë, ju informoni gazetarët se ka ndodhur një rast dhune. Edhe nëse disa gazetarë e kanë raportuar tashmë lajmin dhe kanë qenë të pranishëm në vendngjarje, përmes njoftimit për shtyp ju konfirmoni se policia po merret me këtë rast dhe në këtë mënyrë i krijoni siguri publikut dhe jepni informacione bazë për rastin, duke u kujdesur që të mos rrezikohet viktimja dhe familja e saj.

Duke u dërguar mediave, në mënyrë periodike, njoftime për shtyp rreth veprimtarive tuaja të përditshme për reduktimin e DhBGj-së dhe kontrollin e armëve, ju luani gjithashtu një rol parandalues përmes rritjes së bashkëpunimit me mediat dhe garantoni komunikim të mirë me to.

Megjithatë, është e rëndësishme që njoftimet për shtyp të mos jenë mënyra e vetme e komunikimit me mediat dhe të jeni të hapur për të dhënë deklaratat dhe intervista.

Njoftimet e paplanifikuara për shtyp janë pjesë e komunikimit të krizave dhe duhet t'i përdorni për të zbutur dëmet në rastet kur ka ndodhur diçka e paplanifikuar. Këto lloje njoftimesh janë të zakonshme në punën e policisë sepse veprat penale zakonisht ndodhin papritur.

DEKLARATA



Gazetarët e televizioneve, radiove dhe portaleve, numri i të cilave është në rritje të vazhdueshme, kanë nevojë për deklaratat nga zyrtarët për të plotësuar raportimet e tyre. Në rastin e DhBGj-së, këto deklaratat duhet të bëhen nga persona të sensibilizuar për raste të tilla dhe të vetëdijshëm për pasojat e çdo informacioni që mund të bëhet publik. Nëse policia apo ndonjë

organ kompetent shmang dhënien e deklaratave për tema të caktuara, duke përfshirë për DhBGj-në, atëherë kjo i lë hapësirë publikut të dyshojë nëse këto institucione janë duke punuar siç duhet dhe nëse janë të vetëdijshme për peshën e këtij problemi social.

Deklaratat e mirëmenduara dhe të qarta edukojnë, informojnë, paralajmërojnë dhe krijojnë siguri te publiku, i cili është mjaft i shqetësuar pas rasteve të DhBGj-së.

KONFERENCA PËR SHTYP



Rastet e DhBGj-së që kërkojnë organizimin e konferencave për shtyp janë të rralla. Këto janë raste në të cilat kanë humbur jetën disa persona dhe të cilat kanë krijuar shqetësim te publiku dhe kanë vënë në rrezik disa individë dhe familje. Nevoja për informacion në raste të tilla është e madhe dhe organizimi i një konference për shtyp është një mënyrë për të dërguar mesazhe të qarta për publikun nga një vend i caktuar, përmes të gjitha mediave. Konferencat për shtyp kërkojnë një organizim të mirë, një ndarje të qartë të roleve dhe zëdhënës për shtyp me autoritet dhe elokuentë.

Konferencat për shtyp organizohen në rastet kur jeni të sigurtë se keni një ngjarje që do të tërheqë vëmendjen e mediave dhe kur nuk mund ta sqaroni ngjarjen përmes një njoftimi për shtyp apo deklarate, ose kur ngjarja është aq e rëndësishme sa që nuk mjafton një njoftim për shtyp ose deklaratë për të dhënë të gjitha informacionet me rëndësi për publikun. Është mirë të keni një ekspert që do të tërheqë vëmendjen e mediave dhe që është në gjendje të dërgojë mesazhe të qarta për publikun.

RRJETET SOCIALE



Komunikimi përmes rrjeteve sociale është i pashmangshëm në epokën moderne. Ajo që duhet mbajtur gjithmonë parasysh është se informacioni që shpërndajmë nëpërmjet rrjeteve sociale ka më shumë gjasa që të arrijë te viktimat e mundshme krahasuar me informacionin e shpërndarë përmes mediave tradicionale. Prandaj, është shumë e rëndësishme që në çdo artikull të postuar, në përputhje me rregullat e brendshme për praninë në internet, të vendosni numrat e telefonit dhe të dhënat e tjera të kontaktit që mund të përdoren nga viktimat për të raportuar dhunën. Gjithashtu, rrjetet janë një platformë e shkëlqyer edukimi. Për rrjedhojë, mund t'i përdorni për të informuar qytetarët rreth mënyrave të raportimit të dhunës, mandatit tuaj dhe aspekteve që janë jashtë kompetencave tuaja, statistikave aktuale, procedurave policore dhe rreth çdo elementi tjetër të parashikuar në udhëzimet I dhe II.

DOKUMENTE TË RËNDËSISHME DHE FAQE INTERNET (LINKS) TË DOBISHME

1. Konventa e Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave" (Konventa e Stambollit) ([Shqip/Anlisht/BCMS/Maqedonisht](#))
2. [Publikimet e SEESAC](#), ku përfshihen:
 - a. Burrat dhe armët e zjarrit në Evropën Juglindore: Fakte të shpejta ([Anlisht](#))
 - b. Gjinia dhe armët e zjarrit në Shqipëri: Fakte të shpejta ([Shqip/Anlisht](#))
 - c. Gjinia dhe armët e zjarrit në Bosnjë-Hercegovinë: Fakte të shpejta ([Anlisht/BCMS](#))
 - d. Gjinia dhe armët e zjarrit në Mal të Zi: Fakte të shpejta ([Anlisht/BCMS](#))
 - e. Gjinia dhe armët e zjarrit në Maqedoninë e Veriut: Fakte të shpejta ([Anlisht/Maqedonisht](#))
 - f. Gjinia dhe armët e zjarrit në Serbi: Fakte të shpejta ([Anlisht/BCMS](#))
 - g. Gjinia dhe armët e zjarrit në Kosovë*: Fakte të shpejta ([Shqip/Anlisht/BCMS](#))
 - h. Analiza gjinore e kuadrit ligjor dhe strategjik për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta në Shqipëri ([Shqip/Anlisht](#))
 - i. Analiza gjinore e kuadrit ligjor dhe strategjik për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta në Bosnjë-Hercegovinë: ([Anlisht/BCMS](#))
 - j. Analiza gjinore e kuadrit ligjor dhe strategjik për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta në Malin e Zi ([Anlisht/BCMS](#))
 - k. Analiza gjinore e kuadrit ligjor dhe strategjik për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta në Maqedoninë e Veriut ([Anlisht/Maqedonisht](#))
 - l. Analiza gjinore e kuadrit ligjor dhe strategjik për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta në Kosovë ([Shqip/Anlisht](#))
 - m. Keqpërdorimi i armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje në Evropën Juglindore: Fakte të shpejta ([Anlisht](#))

* Për sa i përket Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, referencat për Kosovën kuptohen në kontekstin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 (1999). Për sa i përket Bashkimit Evropian, ky emërtim nuk cenon qëndrimet lidhur me statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (UNSCR) dhe opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

- n. Gjinia dhe armët e vogla dhe të lehta në Evropën Juglindore ([Shqip/Anlisht/BCMS/Maqedonisht](#))
 - o. Shqipëria: Anketimi për armët e vogla dhe të lehta ([Shqip/Anlisht](#))
 - p. Bosnjë-Hercegovina: Anketimi për armët e vogla dhe të lehta ([Anlisht/BCMS](#))
 - q. Mali i Zi: Anketimi për armët e vogla dhe të lehta ([Anlisht/BCMS](#))
 - r. Maqedonia e Veriut: Anketimi për armët e vogla dhe të lehta ([Anlisht/Maqedonisht](#))
 - s. Serbia: Anketimi për armët e vogla dhe të lehta ([Anlisht/BCMS](#))
 - t. Kosovë: Anketimi për armët e vogla dhe të lehta ([Shqip/Anlisht](#))
3. Perspektiva e grave (How Women Read You?) ([BCMS](#))
 4. [Anketa e udhëhequr nga OSBE për dhunën ndaj grave](#): disa publikime ku përfshihen:
 - a. Anketa e udhëhequr nga OSBE për dhunën ndaj grave në Shqipëri: Mirëqenia dhe siguria e grave ([Anlisht/Shqip](#))
 - b. Anketa e udhëhequr nga OSBE për dhunën ndaj grave në Bosnjë-Hercegovinë: Mirëqenia dhe siguria e grave ([Anlisht/BCMS](#))
 - c. Anketa e udhëhequr nga OSBE për dhunën ndaj grave në Malin e Zi: Mirëqenia dhe siguria e grave ([Anlisht/BCMS](#))
 - d. Anketa e udhëhequr nga OSBE për dhunën ndaj grave në Maqedoninë e Veriut: Mirëqenia dhe siguria e grave ([Anlisht/Maqedonisht/Shqip](#))
 - e. Anketa e udhëhequr nga OSBE për dhunën ndaj grave në Serbi: Mirëqenia dhe siguria e grave ([Anlisht/BCMS](#))
 - f. Anketa e udhëhequr nga OSBE për dhunën ndaj grave në Kosovë: Mirëqenia dhe siguria e grave ([Anlisht/Shqip/BCMS](#))
 5. Udhërrëfytes për një zgjidhje të qëndrueshme për zotërimin e jashtëligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e armëve të vogla dhe të lehta (AVL) dhe municioneve të tyre në Ballkanin Perëndimor, brenda vitit 2024 ([Shqip/Anlisht/BCMS/Maqedonisht](#))
 6. Platforma e Monitorimit të Dhunës me Armë - [në disa gjuhë](#)
 7. Korpusi i legjislacionit rajonal për armët - [në disa gjuhë](#)

CIP - Каталогизација у публикацији
Народна библиотека Србије, Београд

316.774:343.62-055.2

316.774:351.74

623.4:343.62-055.2

UDHËZIM për zyrtarët e ministrive të punëve të brendshme dhe shërbimeve policore për komunikimin me mediat në rastet e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën me bazë gjinore. - Beograd : United nations development programme SEESAC, 2024 (Beograd : Digital solution). - 27 str. ; 25 cm

Izv. stv. nasl.: Smernice za službenike i službenice Ministarstava unutrašnjih poslova i policijskih službi za komunikaciju s medijima u slučajevima zloupotrebe vatrenog oružja u rodno zasnovanom nasilju. - Tiraž 80. - Bibliografija: str. 26-27.

ISBN 978-86-7728-374-2

а) Родно засновано насиље -- Масовни медији б) Оружје -- Злоупотреба -- Родно засновано насиље в) Полиција -- Масовне комуникације

COBISS.SR-ID 152347913

